



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS AUTORITET KOSOVA ZA KONKURENCIJU KOSOVO COMPETITION AUTHORITY
Nr.i Prot./Br. Prot./Prot.No. <u>256/19-0210</u>
Nr.i Fo./Br. St./No.Pg. <u>772</u>
Data/Datum/Date: <u>12.09.2019</u>
PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Nr.34/19
Datë: 12.09.2019

Në mbështetje të nenit 23, nen 28 paragrafi 1 pika 11 dhe nen 29 LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS si dhe LIGJIT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-229 PËR MBROJTJËN E KONKURRENCËS Nr. 04/L-226, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në përbërje të: Valon Prestreshi - Kryetar, Ahmet Krasniqi - Zv. Kryetar, Fatime Haziri - Anëtar, Shaqir Morina Anëtar, Muhamed Krasniqi – anëtar, lidhur me kërkesën nga Banka Qendrore e Kosovës -BQK, Kërkesë mbi Shqyrtimin e çështjes së ndryshimit të tarifave për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia – TPL, në mbledhjen e mbajtur me datën **12.09.2019** jep këtë:

MENDIM PROFESIONAL

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatore** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës dhe misioni i AKK-së është të nxitë dhe sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndermarrje e cila i plotëson kushtet për të konkuruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojë me çmim dhe cilësi.
- III. Banka Qendrore e Kosovës si autoritet rregulator i industrisë së sigurimeve të përkujdeset që Kompanitë e sigurimeve të konkurrojnë me çmime dhe cilësi të shërbimeve që ato ofrojnë.
- IV. Të shmanget bashkëveprimi i kompanive të sigurimeve me njëra-tjetrin në procesin e përllogaritjeve/përcaktimi i primeve, duke mos miratuar dhe orientuar një çmim të njejtë, por ky proces të bazohet në të dhënët e siguruara në mënyrë të pavarur nga kompanitë e sigurimit.
- V. Unifikimi i çmimeve të primit të TPL-së është në kundërshtim me parimet e konkurrencës në një treg të lirë. Banka Qendrore e Kosovës duhet të miratojë tabelat të individualizuara mbështetur në analizën e riskut sipas strukturës/portfolit

të Kompanive të Sigurimit, karakteristikave të produktit dhe strukturës së sigurimeve të secilit ofrues të sigurimeve. Pasi që kompanitë e sigurimeve në Republikën e Kosovës, aktualisht mbajnë çmime të njejtë, Autoriteti sugjeron që të njejtat të jenë bazuar në kushtet e tregut, ofertë – kërkesë, e rrjedhimisht edhe përcaktimi i çmimit të bëhet nën këto kushte.

- VI. Dallimet kryesore në përcaktimin e çmimit të primit të TPL-së ndërmjet kompanive të sigurimeve duhet të rezultojë mbi aftësinë e tyre për të parashikuar humbjet e ardhshme dhe aftësinë e tyre për të ngarkuar primin e duhur për secilën klasë nënshkruese, e cila gjithashtu duhet të jetë e mirëpërcaktuar dhe e saktë. Në varësi të strategjisë së shitjeve, kapaciteteve të kompanisë, si dhe një game të gjerë të parametrave të cilat mund të merren parasysh si mosha e shoferit, vjetërsia e automjetit, lloji i automjeteve, karakteristikave teknike, historiku i dëmeve dhe shumë arsyë të tjera, përcaktimi i çmimeve gjithmonë duhet të bëhet në mënyrë të pavarur.
- VII. Autoriteti i sugjeron BQK-së të shqyrtojë mundësinë e krijimit të grupeve të reja tarifore për mjete të cilat mund të kenë rrezikshmëri më të lartë, duke shmangur ngarkesën për grupet tjera tarifore të cilat nuk kane këtë nivel të rrezikshmërisë.

Autoriteti lëshon këtë mendim profesional duke e trajtuar kërkesën, nga pikëpamjet e Ligjit dhe politikave të konkurrencës.

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**

